



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.115 Prot.

Tiranë, më 02/02/ 2021

V E N D I M

Nr. 18, Datë 02 /02/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.4 Regj, datë 19.01.2021, paraqitur nga Avokate B.L, kundër A.LI, specialiste kadastrë, pranë Bashkisë Cërrik, A.S, polic bashkiak, pranë Bashkisë Cërrik dhe A.Xh, punonjëse e Bashkisë Cërrik, me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe profesionale. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në lidhje me diskriminimin e pretenduar, ankuesja ka parashtruar se:

Unë Avokate B.L, jam avokate e Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr.Liçence xxxxx dhe NIPT xxxxxxxxxxxx.

Origjina ime dhe e famililjes time është nga fshati Gostimë, Bashkia Cërrik. Atje kemi disa prona, për të cilat prindërit e mi gëzojnë titull pronësie dhe më kanë autorizuar me prokurë të përgjithshme. Pasurinë me nr. 69/3/1, Z.K 1820, e ndodhur në Gostimë, e kishte zaptuar H.P. Si pasojë e kësaj, i drejtohem institucionit të pushtetit vendor, Bashkisë Cërrik për të më liruar dhe dorëzuar sendin e paluajjtshëm të llojit arë.

Më datën 02.12.2020, depozitoj pranë Bashkisë Cërrik kërkesën me nr.3345, prot., për ngritjen e komisionit të verifikimit në terren për lirimin dhe dorëzimin e pasurisë. Në datën 11.12.2020 shkojmë në terren bashkë me grupin e punës, i cili përbëhej nga specialistja A.LI,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

dy policë bashkiakë S.K dhe z.A.S, Administratori i Njesisë Administrative Gostimë G.K, topografi pranë Bashkisë Cërrik Z.I, L.H dhe S.L, vëllai im.

Pasi përcaktuam kufijtë në terren, shkuaam në ambjentet e Njesisë Administrative Gostimë për të hartuar dhe nënshkruar procesvervalin për caktimin e kufijve. Specialistja e bashkisë znj.A.Ll, me një sjellje arbitrare dhe një qendrim refraktar po impononte që ne palët, konkretisht unë përfaqësuesja e babait tim dhe personi që na kishte zaptuar pronën të nënshkruanim një marrëveshje ku të thuhej se unë duhet t'i kompesoja kulturën jonxhë në tokën e tij, pra të personit që kishte pushtuar pronën, dhe kur unë të kisha bërë këtë detyrë, atëherë babai im mund të gëzonte, posedonte dhe dispononte pronën e tij. Ky akt ishte në kundërshtim flagrant me ligjin dhe sigurisht që nuk mund të pranoja për ta nënshkruar, por kundërshtova. Specialistja A.Ll mu drejtua me një intonacion të ashpër zëri dhe një qëndrim nënvlerësues dhe diskriminues ndaj profesionit tim duke më thënë shprehimisht: *“Çfar Avokate je ti? Qenke e paaftë. Kështu i mbron klientët e tu?! Mjerë ata. Unë nuk heq asnjë presje nga marrëveshja po të duash nënshkruaje”*. Ndërkohë edhe njëri prej policëve bashkiak u shpreh me fjalë ofenduese dhe diskriminuese për profesionin tim duke më thënë: *“Ti s’ke të drejtë të merresh me këtë çështje, pasi prona nuk është në emrin tënd, le të jesh avokate apo prokurore, nuk na intereson fare. Avokate je tek zyra jote, jo këtu”*

Në datën 21.12.2020, paraqitem përpara Bashkisë Cërrik, për të tërhequr një kopje të akt-marrëveshjes së përpiluar sipas preferencës së specialistes A.Ll, të cilën unë nuk kisha pranuar ta nënshkruaja. Në të njëjtin ambjent ndodheshin edhe dy punonjëse të tjera të bashkisë. Njërin nuk e njoha, ndërsa tjetra ishte A.Xh, e cila është mbesa e qytetarit H.P, i cili ka zaptuar pronën e babait tim. Sapo unë hyj në ambjentin e zyrës A.Xh filloj të bërtiste me fjalë ofenduese kundrejt meje si individ dhe Avokate, duke më diskriminuar për këtë titull të profesionit tim. Konkretisht tha : *“Dil jashtë, dil jashtë, dilë jashtë, Ankelida i thuaj të dali jashtë. Nuk dua viruse brenda, se ti je virusi. Nuk më intereson nëse je Avokate apo çdo gjë tjetër, do njoftoj policinë. Dil jashtë”*

Të gjitha fjalët fyese dhe diskriminuese ndaj meje dhe profesionit tim, të cilat u thanë me dashje dhe qëllim, unë i faktoj nëpërmjet personave dëshmitarë që ishin prezent me mua në të dyja rastet.

Për sa më sipër, kam konstatuar që gjatë ushtrimit të detyrës sime si avokate duke përfaqësuar të drejtat e babait tim në cilësinë e klientit, më janë privuar të drejtat e mia Kushtetuese dhe ligjore, parashikuar nga neni 18, i Kushtetutës, neni 14, i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, neni 2, i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nenet 3, 4, 6, 8, dhe 11, të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 1, të ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga aktet e administruara rezulton se në datën 28.12.2020, ankuesja ka paraqitur një ankesë para Komisionerit duke pretenduar se, gjatë ushtrimit të detyrës së saj si avokate, duke përfaqësuar të drejtat e babait të saj në cilësinë e klientit, ka qenë viktimë e sjelljeve diskriminuese duke i'u privuar të drejtat e saj Kushtetuese dhe ligjore.

Pas shqyrtimit paraprak të këtyre pretendimeve, u konstatua se ankesa kishte mangësi të anës formale, ndër të tjera në lidhje me identifikimin e subjekteve kundër të cilëve ajo drejtonte ankesën dhe pretendimet e ankuses gjithashtu nuk shoqëroheshin me dokumentacionin identifikues, në lidhje me personin dhe statusin e saj si avokate. Në datë 18.01.2021, ankuesja ka plotësuar informacionin në lidhje me subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën dhe ka dorëzuar dokumentacionin identifikues. Pas plotësimit të të metave është regjistruar ankesa me nr. 4 Regj, datë 19.01.2020.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”* Ndërsa në pikat 2 dhe 13, të po këtij neni, parashikohet se: *“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.....13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.”*

Referuar parashikimit të nenit 1, marrë së bashku me përkufizimin e diskriminimit, që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje

nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Thelbi i pretendimeve të ankueses është se, veprimet dhe sjelljet e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, përbëjnë shkele të të drejtave që asaj i burojnë nga ligji nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, si ligj i posaçëm që rregullon ushtrimin e profesionit të avokatit. Ankuesja pretendon se veprimet dhe sjelljet e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, përbëjnë diskriminim për shkak të gjendjes së saj arsimore dhe profesionale. Gjendja arsimore përbën një shkak të mbrojtur të parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga neni 1, i ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Gjendja profesionale, nuk parashikohet si shkak i mbrojtur, por nga shpjegimet e ankueses kuptohet qartë se shkakun i gjendjes arsimore i referohet profesionit të saj si avokate.

Komisioneri nuk i hyn vlerësimit nëse ngjarjet apo sjelljet e pretenduara nga ankuesja kanë ndodhur apo jo, por bazuar në shpjegimet e ankueses nuk rezulton të ketë ndonjë *dallim, përjashtim, kufizim*, që bazohet në gjedjen arsimore apo profesionale të ankueses si avokate. Paligjshmëria e kundërshtuar nga ana e ankueses mund të përbëjë shkelje të të drejtave që ankueses i burojnë në kuadër të ligjit “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, por nuk paraqesin elementë të trajtimit diferencues. Shprehjet dhe sjelljet e pretenduara nga ankuesja se janë konsumuar nga personat kundër të cilëve ankuesja ka paraqitur ankesën, drejtohen kundër saj si person dhe jo kundër profesionit të saj.

Bazuar në përkufizimin që ligj i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar. Bazuar në nenin 32/1/a, të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet : “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe nenin 33 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr.4 regj., datë 19.01.2021, të paraqitur nga ankuese Av.B.L.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja arsimore dhe profesionale
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim